



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 251/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Muhamet Rexha, dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK), dega në Prishtinë, për shkak thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 09.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 08.06.2014 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AKR dega në Prishtinë, thekson se me datë 08.06.2014, rreth orës 15:15, në shkollën fillore “Naim Frashëri”, komisioneri nga radhët e AKR-së Qamil Alshiqi, ka fotografuar një makinë me foto të ngjitura sipër me kandidatët për deputet nga radhët e AAK-së.

Parashtruesi i ankesës ka pretenduar se subjekti politik AAK ka bërë shkelje te Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Në cilësi të provës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit .4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK-në me datë 08.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj saj nga ana e AKR-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankese deri më datë 09.06.2014 në ora 17:00. PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga AAK, në të cilën theksohet se nuk e kanë të qartë dhe kanë kërkuar nga PZAP-i informata shtesë lidhur me ankesën që është bërë ndaj tyre pasi sipas tyre as në shpjegimin e bërë me shkrim dhe as në foto të ofruara nuk është e qartë se për cilin kandidat bëhet fjalë dhe se për çfarë lloj shkeljesh aludon pala ankuese. Me këtë rast subjekti politik AAK përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur disa fotografi si dhe Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së drejtuar të gjitha strukturave të AAK-së për respektimin e Rregullave dhe Ligjin për Zgjedhjet.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nuk mund të vërehet dhe nuk mund të vërtetohet ajo për të cilin pretendon pala ankuese në ankesën e saj, pasi që nga fotografia e ofruar si dëshmi nuk mund të identifikohet qartë se për cilin kandidat për deputet dhe se për cilin subjekt politik bëhet fjalë. Prandaj një pretendim i tillë ankimor është i përgjithshëm dhe i pa bazuar për tu administruar si provë relevante, dhe se për këtë arsye ankesa në fjalë u vlerësua si e pa bazuar, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 251/2014 më datën 09.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*